Gratë në media

dhe dezinformimi me bazë gjinore në Kosovë

Raporti i hulumtimit

Përgatitur nga:

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK)

Gusht 2026

Mirënjohje

Ky raport është përgatitur nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK), në bashkëpunim me Rrjetin e Grave Gazetaretë Kosovës (RRGGK), me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Kosovë përmes fondeve të Mbretërisë së Norvegjisë.

AGK falënderon Getoarbë Mulliqin për kontributin e saj në hulumtim dhe hartimin e raportit, si dhe gazetarët, ekspertët, të anketuarit dhe pjesëmarrësit në grupet e fokusit të cilët kontribuan me plot gatishmëri me kohën, ekspertizën dhe perspektivat e tyre në këtë hulumtim.

Mohim përgjegjësie

Pikëpamjet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimin zyrtar të Misionit të OSBE-së në Kosovë.

Tabela e përmbajtjes

Lista e shkurtesave 6

Përmbledhje ekzekutive 7

1. Hyrje 9
- 1.1 Historiku 10
- 1.2 Qëllimi i raportit 10
- 1.3 Struktura e raportit 10

2. Metodologjia e hulumtimit 11
- 2.1 Dizajni i hulumtimit 12
- 2.2 Mbledhja e të dhënave 12
- 2.3 Validimi rajonal i gjetjeve 14
- 2.4 Aspektet etike 14
- 2.5 Profili i të anketuarve 14
- 2.6 Kufizimet 14

3. Konteksti: Gratë gazetare dhe dezinformimi me bazë gjinore në Kosovë 15
- 3.1. Gratë në gazetari në Kosovë 16
- 3.2. Rreziqet profesionale dhe mjedisi i punës 16
- 3.3. Pse ka rëndësi dezinformimi me bazë gjinore 17

4. Korniza ligjore dhe e politikave 18
- 4.1 Korniza ligjore ndërkombëtare 19
- 4.2 Korniza ligjore e Kosovës 19
- 4.3 Zhvillimet në politikat europiane 20
- 4.4 Zotimet e Kosovës në fushën e politikave 20

5. Gjetjet e hulumtimit 22
- 5.1 Ekspozimi ndaj abuzimit në internet dhe dezinformimit me bazë gjinore 23
- 5.2 Karakteristikat e dezinformimit me bazë gjinore 23
- 5.3 Ndikimi në pjesëmarrjen profesionale dhe mirëqenien 24
- 5.4 Mbështetja Institucionale dhe mekanizmat e raportimit 25
- 5.5 Mjedisi i punës në redaksi dhe mbështetja organizative 25
- 5.6 Platformat digjitale dhe mjedisi i informacionit 26
- 5.7 Prioritetet e të anketuarve për veprim 26

6. Trendet dhe modelet sistemike **27**
6.1 Faktorët nxitës strukturorë dhe socio-kulturorë 28
6.2 Narrativat antigjinore dhe mizogjene 28
6.3 Kritikat politike dhe sulmet ndaj besueshmërisë profesionale 29
6.4 Abuzimi i mundësuar nga teknologjia dhe sulmet ndaj reputacionit 30
6.5 Ndikimi në pjesëmarrjen e grave dhe pluralizmin në media 30
6.6 Sfidat e zbatimit 31

7. Raste ilustruese dhe mësime sistemike **32**
7.1 Abuzimi digjital dhe përmbajtja seksuale e manipuluar: Rasti AlbKings 33
7.2 Ngacmimi i vazhdueshëm dhe kufijtë e reagimit institucional: Rasti i Flutura Kusarit 34
7.3 Kërcënimet, publikimi i të dhënave personale (doxxing) dhe përshkallëzimi përtej kritikave në internet 35
7.4 Delegjitimimi politik dhe sfidat për pavarësinë e gazetarisë 35
7.5 Pasiguria fizike dhe gjinia si faktor që rrit rrezikun 36
7.6 Fushatat e personalizuara të denigrimit dhe narrativat më të gjera kundër barazisë gjinore 36

8. Konkluzionet **36**

9. Rekomandimet **40**
9.1 Institucionet publike, institucionet e zbatimit të ligjit dhe të drejtësisë 41
9.2 Institucionet e pavarura dhe rregullatorët e mediave 41
9.3 Pronarët e mediave, redaktorët dhe menaxherët e redaksive 43
9.4 Asociacionet e Gazetarëve, Rrjetet e Grave Gazetareve dhe Organizatat e Shoqërisë Civile 43
9.5 Partnerët dhe donatorët ndërkombëtarë 44

Referencat **45**

Shtojcat **47**
Shtojca 1. Instrumentet e mbledhjes së të dhënave 47
Shtojca 2. Takimet dhe bashkëbiseduesit 51

Lista e shkurtesave

Shkurtim	Emri i plotë
AIP	Agjencia për Informim dhe Privatësi
AGK	Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
KiE	Këshilli i Evropës
KM	Komiteti i Ministrave (Këshilli i Evropës)
BE	Bashkimi Europian
DHBGJ	Dhuna me bazë gjinore
GREVIO	Grupi i Ekspertëve për Veprime Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
KPM	Komisioni i Pavarur i Mediave
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
IKD	Instituti i Kosovës për Drejtësi
LGBTIQ+	Lezbike, gej, biseksualë, transgjinorë, interseksualë dhe queer
RrGGK	Rrjeti i Grave Gazetare të Kosovës
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
QIKA	Qendra për Informim, Kritikë dhe Aksion
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
TV	Televizion
KB	Kombet e Bashkuara
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë
UN Women	Enti i Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizimin e Grave

Përmbledhje ekzekutive

Gratë gazetare luajnë një rol jetësor në mbrojtjen e lirisë së mediave dhe debatit demokratik. Në të njëjtën kohë, komunikimi digjital ka krijuar forma të reja rreziku, duke përfshirë ngacmimin online, dezinformimin me bazë gjinore dhe dhunën e mundësuar nga teknologjia, fenomene që prekin veçanërisht gratë aktive në jetën publike. Këto sulme shpesh shkojnë përtej kritikave ndaj punës gazetareske dhe e shënjestrojnë besueshmërinë profesionale të grave, jetën private, pamjen, moralin ose përkatësitë e perceptuara politike, duke ndikuar në pjesëmarrjen e tyre në gazetari dhe debat publik.

Ky raport shqyrton natyrën dhe ndikimin e dezinformimit me bazë gjinore që prek gratë gazetare dhe gratë që punojnë në sektorin e mediave në Kosovë. I përgatitur nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) dhe Rrjeti i Grave Gazetare të Kosovës (RrGGK), studimi kombinon hulumtimin e dokumentacionit, një anketë sasiore të 54 grave gazetare dhe profesionisteve të mediave, intervista cilësore me ekspertë, konsultime me gazetare, përvojat e të cilave kanë shërbyer si bazë për rastet studimore të përzgjedhura, dhe një diskutim në grup fokusi me anëtaret e Rrjetit të Grave Gazetare të Kosovës. Si tërësi, këto metoda ofrojnë një bazë fillestare provash për të kuptuar se si manifestohet dezinformimi me bazë gjinore në Kosovë dhe si institucionet dhe organizatat mediatike mund të reagojnë në mënyrë më efektive.

Gjetjet tregojnë se abuzimi, ngacmimi dhe dezinformimi në internet me bazë gjinore përbëjnë shqetësime të rëndësishme për gratë gazetare pjesëmarrëse. Gjashtëdhjetë e një përqind e të anketuarve raportuan se kishin përjetuar abuzim ose ngacmim në internet në lidhje me punën e tyre profesionale, ndërsa gjysma e të anketuarve deklaruan se ishin shënjestruar edhe nga narrativa të rreme ose mashtruese me bazë gjinore. Pjesëmarrësit përmendën sulmet që përqendroheshin në moralin, dukjen, jetën private dhe besueshmërinë profesionale të tyre në vend të përmbajtjes së raportimit të tyre. Shumë të anketuar raportuan gjithashtu pasoja që shtriheshin përtej incidenteve individuale, duke përfshirë ngurrimin për të marrë pjesë në debate publike, shmangien e temave të ndjeshme të raportimit, stresin, ankthin dhe zvogëlimin e besimit profesional.

> Hulumtimi tregon më tej se sulmet me bazë gjinore rrallë ndodhin si të izoluara. Në vend të kësaj, ato shpesh kryqëzohen me forma të tjera të abuzimit të mundësuar nga teknologjia, duke përfshirë kërcënimet, ngacmimin, doxxing-un, imazhet e manipuluara seksuale dhe sulmet ndaj reputacionit. Edhe përkundër faktit që këto forma të sjelljes duhet të mbeten të dallueshme ligjërisht dhe analitikisht, së bashku ato kontribuojnë në një mjedis gjithnjë e më armiqësor për gratë gazetare dhe gratë e tjera që marrin pjesë në jetën publike. Raporti gjithashtu thekson faktorë më të gjerë strukturorë, duke përfshirë stereotipet e rrënjosura gjinore, narrativat antigjinore dhe retorikën politike që vë në pikëpyetje pavarësinë dhe legjitimitetin profesional të grave.

Studimet ilustruese të rasteve demonstrojnë manifestime të ndryshme të këtyre sfidave. Ato përfshijnë ngacmimin kolektiv online të lidhur me grupin AlbKings në platformën Telegram, ngacmimin e vazhdueshëm online ndaj juristes së mediave Flutura Kusari, kërcënimet dhe doxxing-un ndaj gazetarëve hulumtues, sulmet publike që vënë në dyshim pavarësinë e grave gazetare dhe sulmin fizik ndaj gazetares

Tatjana Lazarević gjatë raportimit në veri të Kosovës. Në vend që t'i paraqesë këto incidente si ngjarje të izoluara, raporti i analizon ato si shembuj të çështjeve më të gjera sistemike që lidhen me sigurinë digjitale, mbrojtjen institucionale, përgjigjet ligjore dhe pjesëmarrjen e grave në gazetari.

Raporti arrin në përfundimin se Kosova zotëron një kornizë të rëndësishme ligjore dhe të politikave për mbrojtjen e grave nga dhuna dhe diskriminimi, duke përfshirë zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të Konventës së Stambollit dhe zotimet e tjera sipas standardeve ndërkombëtare dhe evropiane të të drejtave të njeriut. Megjithatë, zbatimi përcillet me sfida të shumta në fusha të tilla si koordinimi institucional, mbledhja e provave, hetimet digjitale, procedurat e redaksive dhe mekanizmat mbështetës për gratë gazetare që përjetojnë abuzim të mundësuar nga teknologjia. Në të njëjtën kohë, raporti përmend zhvillime të rëndësishme pozitive, duke përfshirë punën e vazhdueshme të AGK dhe RrGGK në dokumentimin e sulmeve kundër gazetareve dhe mbështetjen e viktimave, si dhe angazhimin strategjik të kohëve të fundit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës[1] për forcimin e përgjigjeve ndaj dhunës ndaj gazetarëve.

Raporti rekomandon një reagim të koordinuar të të gjithë akterëve përfshirë institucionet publike, institucionet e zbatimit të ligjit dhe drejtësisë, organet rregullatore të pavarura, organizatat mediatike, shoqatat e gazetarëve, organizatat e shoqërisë civile, platformat teknologjike dhe partnerët ndërkombëtarë. Ndër prioritetet kryesore janë forcimi i kapacitetit institucional për t'iu përgjigjur abuzimit të mundësuar nga teknologjia, përmirësimi i mbledhjes së provave digjitale, krijimi i mekanizmave të raportimit në redaksinë e lajmeve, zgjerimi i mbështetjes ligjore, psikosociale dhe të sigurisë digjitale për gratë gazetare, përmirësimi i mbledhjes së të dhënave dhe koordinimi institucional, si dhe promovimi i njohurive mediatike dhe praktikave profesionale të ndjeshme ndaj gjinisë. Së bashku, këto masa mund të kontribuojnë në një mjedis më të sigurt mediatik, të forcojnë lirinë e shprehjes së grave dhe të kontribuojnë në barazi më të madhe gjinore brenda sektorit të mediave në Kosovë.

[1] Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Plani Strategjik Gjyqësor 2025–2030. Miratuar më 12 shkurt 2026. Në dispozicion në: https://www.gjyqesori-rks.org/2026/02/12/kgjk-miraton-planin-strategjik-2026-2028/

1.

Hyrje

1.1 Historiku

Dezinformimi me bazë gjinore është shfaqur si një sfidë gjithnjë e më e rëndësishme në temat e lirisë së mediave, barazisë gjinore dhe pjesëmarrjes demokratike. Narrativat e rreme, mashtruese ose të manipuluara që bazohen në stereotipe gjinore mund ta dëmtojnë besueshmërinë e grave, ta dekurajojnë pjesëmarrjen e tyre në debatin publik dhe të kontribuojnë në modele më të gjera të abuzimit dhe frikësimit në internet. Gratë gazetare, së bashku me gratë aktive në politikë, shoqërinë civile dhe jetën publike, mund të preken veçanërisht kur kritika publike ose dezinformimi bazohet në narrativa që në shënjestër e kanë gjininë, pamjen, moralin, rolet familjare ose kompetencën e tyre profesionale.

Për qëllimet e këtij raporti, dezinformimi me bazë gjinore i referohet informacionit të rremë, mashtrues ose të manipuluar që përdor stereotipe gjinore, narrativa seksiste ose pritshmëri të krijuara nga normat shoqërore në lidhje me gratë dhe burrat për t'i diskredituar individët, për ta cenuar besueshmërinë e tyre ose për ta dekurajuar pjesëmarrjen e tyre në debatin publik. Ndryshe nga dezinformimi në përgjithësi, dezinformimi me bazë gjinore shfrytëzon stereotipet gjinore dhe normat gjinore të ndërtuara nga shoqëria për ta rritur dëmtimin e reputacionit dhe për ta kufizuar pjesëmarrjen e grave në jetën publike.

Duke ditur rëndësinë e kuptimit të këtij fenomeni, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) krijoi Rrjetin e Grave Gazetare të Kosovës (RrGGK) për të shqyrtuar se si dezinformimi me bazë gjinore ndikon te gratë gazetare dhe gratë që punojnë në sektorin e mediave në Kosovë. Duke u bazuar në hulumtime të dokumentacionit, një anketë, intervista cilësore dhe një diskutim në grup fokusi, raporti analizon përvojat dhe perceptimet e grave gazetare, shqyrton raste ilustruese të zgjedhura, kornizën ligjore dhe politike të zbatueshme dhe identifikon rekomandime që synojnë forcimin e përgjigjeve institucionale, sigurinë e gazetarëve dhe barazinë gjinore në sektorin e mediave.

1.2 Qëllimi i raportit

Qëllimi i këtij raporti është të shqyrtojë se si dezinformimi me bazë gjinore ndikon te gratë gazetare dhe gratë që punojnë në sektorin e medias në Kosovë. Duke u mbështetur në një qasje kërkimore me metoda të përziera, raporti shqyrton format dhe manifestimet e dezinformimit me bazë gjinore, ndikimin e tij në punën profesionale të grave, sigurinë dhe pjesëmarrjen publike, si dhe përgjigjet institucionale ndaj këtyre sfidave. Raporti gjithashtu identifikon boshllëqet në kornizën ekzistuese ligjore, politike dhe institucionale dhe propozon rekomandime që synojnë forcimin e mbrojtjes së grave gazetare, promovimin e barazisë gjinore dhe rritjen e qëndrueshmërisë së sektorit të medias kundër dezinformimit me bazë gjinore.

1.3 Struktura e raportit

Pas kësaj hyrjeje, raporti paraqet metodologjinë e hulumtimit dhe shpjegon qasjen me metoda të përziera të përdorura për të mbledhur dhe analizuar të dhënat. Më pas, ofron kontekstin më të gjerë të grave gazetare dhe dezinformimit me bazë gjinore në Kosovë, përpara se të shqyrtojë kornizën e zbatueshme ligjore dhe politike ndërkombëtare, europiane dhe vendore. Kapitujt qendrorë paraqesin gjetjet e hulumtimit, analizojnë trendet dhe modelet më të gjera dhe diskutojnë një numër rastesh studimore ilustruese që tregojnë se si dezinformimi me bazë gjinore manifestohet në praktikë. Raporti përfundon me konkluzione dhe rekomandime kryesore për institucionet publike, organizatat mediatike, shoqatat e gazetarëve, shoqërinë civile, partnerët ndërkombëtarë dhe akterët tjerë përkatës.

2.

Metodologjia e hulumtimit

2.1 Dizajni i hulumtimit

Ky studim përdori një dizajn kërkimor me metoda të përziera duke kombinuar hulumtimin e dokumentacionit, intervistat cilësore, një diskutim në grup fokusi dhe një anketë sasiore për të shqyrtuar se si dezinformimi me bazë gjinore ndikon te gratë gazetare dhe gratë që punojnë në sektorin e medias në Kosovë. Metodologjia u hartua dhe u zbatua bashkërisht nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) dhe Rrjeti i Grave Gazetare të Kosovës (RrGGK), duke ndërthurur ekspertizën e AGK-së në sigurinë e gazetarëve dhe realitetet e redaksisë me përvojën e RrGGK-së në promovimin e barazisë gjinore dhe mbështetjen e grave gazetare.

Në këtë hulumtim është përdorur një qasje me metoda të përziera për t'i kombinuar provat sasiore dhe cilësore, duke mundësuar që të shqyrtohet si përhapja e përvojave të zgjedhura midis të anketuarve ashtu edhe konteksti më i gjerë në të cilin dezinformimi me bazë gjinore ndikon te gratë që punojnë në sektorin e medias. Hulumtimi u bazua në disa parime metodologjike, duke përfshirë triangulimin e burimeve të shumëfishta të provave, zbatimin e një qasjeje të ndjeshme ndaj gjinisë, mbrojtjen e dinjitetit dhe konfidencialitetit të pjesëmarrësve dhe përshtatjen e standardeve ndërkombëtare në mjedisin mediatik të Kosovës.

2.2 Mbledhja e të dhënave

Hulumtimi i dokumentacionit

Hulumtimi filloi me një shqyrtim të literaturës vendore dhe ndërkombëtare mbi dezinformimin me bazë gjinore, dhunën online ndaj grave, sigurinë e gazetarëve, lirinë e medias dhe barazinë gjinore. Gjatë kësaj faze u shqyrtuan gjithashtu raportet e prodhuara nga shoqatat e gazetarëve, nga iniciativat për verifikimin e fakteve, nga organizatat ndërkombëtare dhe botime të tjera relevante.

I tërë ky proces u plotësua edhe nga një shqyrtim i përmbajtjes së mediave tradicionale dhe digjitale[2] për të identifikuar narrativat e përsëritura që përfshijnë dezinformimin me bazë gjinore, ngacmimin online, gjuhën e urrejtjes dhe sulmet ndaj reputacionit që në shënjestër i kanë gratë gazetare dhe gratë e tjera aktive në jetën publike. Gjersa raporti përqendrohet kryesisht në zhvillimet gjatë vitit 2025, ai mbështetet gjithashtu në raste të zgjedhura të dokumentuara nga vitet e mëparshme për të ofruar një kuptim më të gjerë kontekstual të trendeve në zhvillim. Gjetjet nga shqyrtimi i dokumentacionit shërbyen si bazë për zhvillimin e pyetësorit të anketës, udhëzuesit të intervistës dhe udhëzuesit të diskutimit në grupin e fokusit.

Intervistat cilësore

Komponenti cilësor i hulumtimit përfshinte pesë intervista gjysmë të strukturuara me ekspertë, akterë dhe gra të prekura drejtpërdrejt nga dezinformimi me bazë gjinore. Intervistat shqyrtuan përvojat dhe perspektivat e pjesëmarrësve në lidhje me dezinformimin me bazë gjinore, sigurinë e gazetarëve, praktikat

[2] Rishikimi i përmbajtjes mediatike u përqendrua kryesisht në Kosovë dhe u bazua në raste publike, përmbajtje mediatike, materiale monitorimi dhe dokumentacion ekzistues të prodhuar nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, Rrjeti SafeJournalists, iniciativat për verifikimin e fakteve dhe hulumtime, organizata të shoqërisë civile dhe raporte relevante të medias. Materialet e shqyrtuara ishin kryesisht në shqip dhe anglisht, me burime në gjuhën serbe të përfshira aty ku ishte relevante për raste specifike ose ku kishte dokumentacion. Edhe pse raporti përqendrohet kryesisht në zhvillimet gjatë vitit 2025, në të përfshihen edhe incidente të zgjedhura të dokumentuara nga vitet e mëparshme bazuar në rëndësinë e tyre për pyetjet e hulumtimit, disponueshmërinë e informacionit publik të dokumentuar mjaftueshëm dhe vlerën e tyre në ilustrimin e modeleve të përsëritura ose zhvillimeve kontekstuale.

e redaksisë, përgjigjet institucionale, sfidat ligjore dhe masat e mundshme për t'i forcuar mekanizmat mbrojtës.

Të dhënat e intervistave u analizuan tematikisht për t'i identifikuar modelet e përsëritura, faktorët kontekstualë dhe çështjet relevante për gratë gazetare në Kosovë. Citate të përzgjedhura nga intervistat janë përdorur në tërë raportin për t'i ilustruar gjetjet kryesore dhe për të ofruar kontekst shtesë.

Diskutimi në grupe të fokusit

Për t'i kontekstualizuar më tej gjetjet e hulumtimit, u zhvillua një diskutim në grup fokusi që përfshinte njëzet anëtare të Rrjetit të Grave Gazetare të Kosovës (RrGGK). Pjesëmarrëset reflektuan mbi përvojat e tyre profesionale, ekspozimin ndaj dezinformimit me bazë gjinore, strategjitë për t'iu përgjigjur abuzimit në internet dhe mbështetjen institucionale në dispozicion të grave gazetare. Diskutimi gjithashtu ofroi një pasqyrë shtesë cilësore se si narrativat me bazë gjinore ndikojnë në mjedisin e punës së grave, dukshmërinë publike dhe qëndrueshmërinë profesionale.

Anketa sasiore

U krye edhe një anketë sasiore me 54 gra gazetare dhe gra që punojnë në sektorin e medias në tërë Kosovën duke përdorur një pyetësor të strukturuar online. Anketa mblodhi informata demografike së bashku me përvojat e të anketuarave me abuzimin dhe ngacmimin online, ekspozimin ndaj dezinformimit me bazë gjinore, format e sulmeve të përjetuara, ndikimin e tyre në pjesëmarrjen profesionale dhe mirëqenien, perceptimet për përgjigjet e redaksisë dhe ato institucionale, platformat digjitale ku u has përmbajtje abuzive dhe rekomandimet për përmirësimin e mekanizmave të mbrojtjes. Grupi i të dhënave të anketës nuk ka për qëllim të përbëjë një mostër përfaqësuese të grave gazetare në tërë Kosovën. Përkundrazi, ai ofron një set të dhënash analitike që ndihmon në identifikimin e modeleve, perceptimeve dhe përvojave të përsëritura në lidhje me abuzimin online, keqinformimin, dezinformimin dhe dezinformimin me bazë gjinore që prekë gratë që punojnë në sektorin e medias.

Anketa sasiore u krye në periudhën ndërmjet 13 dhe 26 dhjetorit 2025. Të anketuarit u rekrutuan duke përdorur një qasje të mostrës jo-probabilitare të qëllimshme dhe të përshtatshme, me qëllim përfshirjen e gazetareve dhe profesionisteve të medias që punojnë në sektorë të ndryshëm të medias, me role profesionale dhe prejardhje të ndryshme komunitare në Kosovë. Ftesa për pjesëmarrje u shpërnda përmes rrjeteve profesionale të Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës (AGK) dhe Rrjetit të Grave Gazetare të Kosovës (RrGGK), duke përfshirë ftesa të drejtpërdrejta me e-mail dhe komunikim me gazetaret, redaktoret, organizatat mediatike dhe kontakte të tjera profesionale relevante. Pjesëmarrja ishte vullnetare dhe anonime. Meqenëse mostra nuk ishte hartuar për të qenë statistikisht përfaqësuese, gjetjet duhet të interpretohen si treguese të përvojave dhe perceptimeve të pjesëmarrësve të anketuar dhe jo si vlerësime për të gjitha gratë që punojnë në sektorin e medias në Kosovë.

2.3 Validimi rajonal i gjetjeve

Perspektivat rajonale të ndara gjatë takimit të Rrjetit SafeJournalists në prill 2026 në Beograd treguan se shumë nga përvojat e dokumentuara në Kosovë pasqyrohen në tërë Ballkanin Perëndimor. Pjesëmarrësit raportuan modele të ngjashme të sulmeve mizogjene dhe të seksualizuara kundër grave gazetare, njollosje të reputacionit, ngacmim kolektiv në internet, amplifikim politik të narrativave armiqësore, përgjigje të dobëta institucionale dhe mekanizma të kufizuar të brendshëm të redaksisë. Diskutimet theksuan gjithashtu se sulme të tilla kontribojnë në vetëcensurë, dukshmëri të reduktuar publike dhe një ngurrim në mesin e grave gazetare për të raportuar mbi çështje politikisht të ndjeshme ose të lidhura me gjininë. Në të njëjtën kohë, pjesëmarrësit vunë re dallime në kapacitetin institucional dhe përgjigjet ligjore në të gjitha vendet, duke përforcuar rëndësinë e bashkëpunimit rajonal, shkëmbimin e praktikave të mira dhe standardet më të forta të dokumentimit.

2.4 Aspektet etike

Të gjitha aktivitetet kërkimore u kryen në përputhje me parimet etike dhe të ndjeshme ndaj gjinisë. Pjesëmarrja ishte vullnetare, konfidenciale dhe anonime, ndërsa ekspertët e intervistuar dhe gazetarët e konsultuar për studimet ilustruese të rasteve identifikohen me emër në raport. Vëmendje e veçantë iu kushtua mbrojtjes së pjesëmarrësve që diskutonin përvojat e ngacmimit, frikësimit ose formave të tjera të abuzimit. Gjatë gjithë procesit të kërkimit, u bënë përpjekje për ta minimizuar rrezikun e stigmës, diskriminimit ose ritraumatizimit.

2.5 Profili i të anketuarve

Anketa përfshiu 54 gra gazetare dhe gra që punojnë në sektorin e medias në tërë Kosovën.
Në mesin e të anketuarave, 47 u identifikuan si shqiptarë të Kosovës, katër si serbë të Kosovës, dy si romë të Kosovës dhe një si turk i Kosovës. Shumica e të anketuarave (81%) punonin në televizion ose media online, ndërsa pjesa tjetër punonte në radio, media sociale ose si gazetare të pavarura. Gati dy të tretat (64%) kishin pozita raportimi ose pozita editoriale të nivelit të mesëm, ndërsa 5% mbanin pozita të larta editoriale ose menaxheriale.

2.6 Kufizimet

Gjetjet e paraqitura në këtë raport duhet të interpretohen duke pasur parasysh fushëveprimin metodologjik të studimit. Anketa ofron një pasqyrë të përvojave dhe perceptimeve të të anketuarve pjesëmarrës, por nuk ka për qëllim të përbëjë një mostër statistikisht përfaqësuese të të gjitha grave gazetare dhe grave që punojnë në sektorin e medias në Kosovë. Ngjashëm, intervistat cilësore dhe diskutimet në grupe fokusi ofrojnë kuptim kontekstual dhe perspektiva ilustruese në vend të konkluzioneve në nivel popullsie. Përdorimi i metodave të shumta kërkimore kishte për qëllim të forconte besueshmërinë e gjetjeve përmes triangulimit metodologjik.

Përveç kësaj, numri relativisht i vogël i të anketuarve nga komunitetet individuale jo-shumicë dhe nëngrupet e tjera nuk mundëson një analizë të fuqishme në nivel komuniteti ose në nivel ndërthurjeje. Kur paraqiten të dhëna të nëngrupeve, ato duhet të interpretohen vetëm si përshkruese dhe të raportohen në një mënyrë që mbron konfidencialitetin dhe anonimitetin e pjesëmarrësve.

3.

Konteksti: Gratë gazetare dhe dezinformimi me bazë gjinore në Kosovë

3.1. Gratë në gazetari në Kosovë

Gratë luajnë një rol të rëndësishëm në sektorin e medias në Kosovë. Sipas Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës (AGK), afërsisht 65% e anëtarëve të saj janë gra, duke reflektuar përfaqësimin e fortë të grave brenda asociacionit. AGK gjithashtu vëren një numër në rritje të grave që ndjekin studime dhe karriera në gazetari në sektorin e medias.

Megjithatë, përfaqësimi numerik nuk përkthehet domosdoshmërisht në ndikim, lidership ose mbrojtje institucionale të barabartë. Gazetaret vazhdojnë të përballen me sfida në mjedisin e tyre profesional, duke përfshirë komentet seksiste, diskreditimin profesional, presionin nga redaktorët ose burimet, ngacmimin online të lidhur me raportimin e tyre dhe mekanizma të kufizuar të brendshëm brenda redaksive për të raportuar ose adresuar incidente të tilla. Akterët e konsultuar gjatë këtij hulumtimi theksuan gjithashtu shqetësimet në lidhje me pjesëmarrjen e grave në pozita të larta editoriale dhe vendimmarrëse dhe nevojën për ta forcuar mbështetjen institucionale brenda organizatave mediatike.

3.2. Rreziqet profesionale dhe mjedisi i punës

Ashtu si kolegët e tyre meshkuj, gratë gazetare raportojnë rregullisht nga mjedise politikisht të ndjeshme dhe me rrezik të lartë, duke përfshirë protestat, operacionet e sigurisë dhe zonat me tension të lartë. Ky raport nuk e paraqet ekspozimin ndaj mjediseve të tilla si një fenomen specifik për gratë. Përkundrazi, ai thekson se kur gratë gazetare janë në shënjestër në këto kontekste, ato mund të përjetojnë edhe forma të kërcënimit specifik për gjininë, duke përfshirë ngacmimin seksual, sulmet ndaj reputacionit, kërcënimet ndaj privatësisë dhe abuzimin në internet që në shënjestër ka jetën e tyre personale ose besueshmërinë profesionale.

> Këto rreziqe u bënë veçanërisht të dukshme gjatë protestave dhe incidenteve të sigurisë në veri të Kosovës në maj dhe qershor 2023, kur disa gazetare iu nënshtruan frikësimit, kërcënimeve, sulmeve fizike dhe formave të tjera të presionit gjersa raportonin nga terreni.[3] Përtej rrezikut të menjëhershëm fizik, disa incidente ngritën gjithashtu shqetësime në lidhje me sigurinë digjitale, mbrojtjen e burimeve dhe privatësinë, duke përfshirë raste në të cilat gazetaret nuk ishin në gjendje t'i rikthenin telefonat e tyre celularë pas sulmeve, duke ekspozuar potencialisht burime konfidenciale, të dhëna personale dhe komunikime profesionale.

Ndërkohë që rreziqe të tilla mund t'i prekin gazetarët pavarësisht nga gjinia, ato mund të fitojnë një dimension të dallueshëm gjinor kur kombinohen me ngacmim të seksualizuar[4], sulme ndaj reputacionit,

[3] Rastet e dokumentuara përfshijnë sulmet kundër Venera Xhoxhaj, Saranda Ramaj dhe Doruntina Thaçi, së bashku me incidente të tjera që përfshijnë gra gazetare, raste të regjistruara nga AGK në mesin e qershorit 2023.

[4] Për qëllimet e këtij raporti, ngacmimi i referohet sjelljes së përsëritur ose të synuar, në internet ose jashtë internetit, që frikëson, poshtëron, kërcënon ose krijon një mjedis armiqësor për një gazetare ose grua në një rol public, për shkak të punës së saj, dukshmërisë publike, gjinisë ose pikëpamjeve të perceptuara. Fushatat e shpifjes së seksualizuar i referohen përpjekjeve të koordinuara ose të përsëritura për ta diskredituar një grua duke përdorur përmbajtje seksuale të rreme, mashtruese, degraduese ose të nënkuptuara, duke përfshirë sulme ndaj moralit, pamjes, jetës private, marrëdhënieve ose trupit të saj, në vend që të merren me punën e saj profesionale ose deklaratat publike.

doxxing[5] dhe kërcënime[6] ndaj jetës private, familjeve, integritetit trupor ose besueshmërisë profesionale të grave. Këto zhvillime ilustrojnë se kërcënimet ndaj grave gazetare në Kosovë nuk kufizohen vetëm në sferën digjitale, por mund të ndikojnë edhe në sigurinë e tyre fizike, privatësinë, mbrojtjen e burimeve dhe aftësinë për të kryer detyrat e tyre profesionale.

3.3. Pse ka rëndësi dezinformimi me bazë gjinore

Gazetaret dhe gratë e tjera aktive në jetën publike përballen gjithnjë e më shumë me keqinformim[7] dhe dezinformim[8] që mbështetet në stereotipe gjinore dhe narrativa diskriminuese. Përmbajtja e tillë mund të synojë kompetencën profesionale të grave, integritetin personal, pamjen, moralin, rolet familjare ose përkatësitë e perceptuara politike, dhe rezulton në cenimin e besueshmërisë së tyre dhe dekurajimin e pjesëmarrjes së tyre në debatin publik.

Në Kosovë, këto narrativa shpesh përforcojnë stereotipet e dëmshme që prekin gratë në gazetari, politikë, shoqëri civile dhe role të tjera të dukshme publike. Përtej ndikimit të tyre tek gratë individuale, dezinformimi me bazë gjinore mund të kontribojë në modele më të gjera përjashtimi duke dekurajuar pjesëmarrjen qytetare, duke përforcuar normat sociale diskriminuese dhe duke dobësuar cilësinë e diskursit publik.

Në këtë kontekst, ky raport shqyrton përvojat e grave gazetare dhe grave që punojnë në sektorin e medias në Kosovë, analizon raste ilustruese të përzgjedhura dhe identifikon masa institucionale dhe politike që mund të kontribuojnë në forcimin e sigurisë së gazetarëve, barazisë gjinore dhe qëndrueshmërisë ndaj dezinformimit me bazë gjinore.

[5] Doxxing i referohet publikimit ose ndarjes së informacionit privat ose identifikues të një personi, siç janë numrat e telefonit, adresat e shtëpisë, fotografitë personale, të dhënat familjare ose informacionet e vendit të punës, pa pëlqimin dhe shpesh me qëllim ekspozimin e tyre ndaj ngacmimit, frikësimit ose abuzimit të mëtejshëm.

[6] Ky formulim i referohet kërcënimeve dhe frikësimeve gjinore që shkojnë përtej kritikave ndaj punës profesionale dhe në vend të kësaj synojnë sigurinë personale të grave, integritetin trupor, anëtarët e familjes, marrëdhëniet private, reputacionin ose legjitimitetin e perceptuar moral dhe profesional.

[7] Keqinformimi i referohet informacionit të rremë, të pasaktë ose mashtrues që ndahet pavarësisht nëse ka qëllim për të shkaktuar dëm. Në këtë raport, termi përdoret për të përshkruar përmbajtje të pasaktë ose mashtruese që mund të ndikojë në kuptimin publik të roleve, të drejtave, besueshmërisë ose pjesëmarrjes së grave në jetën publike.

[8] Dezinformimi i referohet informacionit të rremë, mashtrues ose të manipuluar që krijohet ose shpërndahet qëllimisht me qëllim mashtrimin, dëmtimin, diskreditimin ose manipulimin e individëve, grupeve ose debatit publik. Në këtë raport, termi përdoret veçanërisht në lidhje me narrativat që në shënjestër i kanë gazetaret, figurat publike, aktivistet ose çështjet e barazisë gjinore.

4.

Korniza ligjore dhe e politikave

4.1 Korniza ligjore ndërkombëtare

Instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut ofrojnë kornizën normative për parandalimin dhe adresimin e dhunës ndaj grave, duke përfshirë format e dhunës së mundësuar përmes teknologjive digjitale. Dy instrumente janë veçanërisht të rëndësishme për temën e këtij raporti: Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) dhe Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit).

Edhe pse këto instrumente nuk rregullojnë në mënyrë specifike mbrojtjen e gazetarëve, ato përcaktojnë detyrime për autoritetet publike për të parandaluar, hetuar dhe reaguar ndaj dhunës ndaj grave në sfera të ndryshme të jetës, duke përfshirë sjelljet që ndodhin përmes teknologjive digjitale dhe mjediseve online.

Konventa e Stambollit është drejtpërdrejt e zbatueshme në Kosovë sipas nenit 22 të Kushtetutës.[9] Prandaj, dispozitat e saj janë të rëndësishme kur merren në konsideratë format e dhunës së mundësuar nga teknologjia që prekin gratë gazetare dhe gratë e tjera aktive në jetën publike. Në veçanti, Neni 17 i Konventës[10] thekson rolin e sektorit të medias dhe teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në promovimin e politikave dhe praktikave që kontribojnë në parandalimin e dhunës ndaj grave.

> Grupi i Ekspertëve për Veprim Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO), organ i pavarur monitorues i krijuar sipas Konventës së Stambollit, ka theksuar gjithashtu dimensionin digjital në rritje të dhunës ndaj grave. Në Rekomandimin e Përgjithshëm Nr. 1 mbi Dimensionin Digjital të Dhunës ndaj Grave, GREVIO thekson se dhuna e mundësuar nga teknologjia, duke përfshirë ngacmimin në internet dhe format e tjera të abuzimit me bazë gjinore, mbetet dukshëm e nën-raportuar dhe shpesh e adresuar jo mjaftueshëm nga mekanizmat ekzistues të mbrojtjes institucionale.[11]

4.2 Korniza ligjore e Kosovës

Kosova ka krijuar një kornizë ligjore dhe të politikave që synon promovimin e barazisë gjinore dhe mbrojtjen e grave nga dhuna dhe diskriminimi. Instrumentet përkatëse vendore përfshijnë Ligjin për Barazinë Gjinore, Ligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore, së bashku me strategji dhe politika më të gjera vendore që adresojnë barazinë gjinore, dhunën ndaj grave, sigurinë e gazetarëve dhe llogaridhënien në media.

Si tërësi, këto instrumente ofrojnë një kornizë të rëndësishme për mbrojtjen e grave nga diskriminimi dhe dhuna, duke promovuar njëkohësisht barazinë dhe pjesëmarrjen në jetën publike. Edhe pse ato nuk

[9] Rezniqi, Arrita. (2022). Konventa e Stambollit në Vendimet e Gjykatave në Kosovë. Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD). Në dispozicion në: https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2023/03/The-Istanbul-Convention-in-the-verdicts-of-courts-in-Kosovo_ENG.pdf (qasur në korrik 2026).

[10] Neni 17 i Konventës së Stambollit ka të bëjë me pjesëmarrjen e sektorit privat, sektorit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe medias në parandalimin e dhunës ndaj grave. Ai u bën thirrje shteteve të inkurajojnë këta aktorë, duke respektuar lirinë e shprehjes dhe pavarësinë e medias, të marrin pjesë në zhvillimin e politikave, udhëzimeve dhe standardeve vetërregulluese që parandalojnë dhunën ndaj grave dhe promovojnë respektin për dinjitetin e grave.

[11] GREVIO. (2021). Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 1 mbi Dimensionin Digjital të Dhunës ndaj Grave. Grupi i Ekspertëve për Veprim Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO), Këshilli i Evropës. Miratuar më 20 tetor 2021. Në dispozicion në: https://rm.coe.int/grevio-rec-no-on-digital-violence-against-women/1680a49147 (qasur në korrik 2026).

rregullojnë në mënyrë specifike dezinformimin me bazë gjinore që prek gratë gazetare, ato përcaktojnë parime që janë të rëndësishme për parandalimin e dhunës me bazë gjinore[12], duke promovuar barazinë dhe duke forcuar përgjigjet institucionale aty ku gratë përjetojnë abuzim të mundësuar nga teknologjia.

4.3 Zhvillimet në politikat europiane

Përpjekjet institucionale të Kosovës për të forcuar mbrojtjen kundër dhunës me bazë gjinore zhvillohen gjithashtu brenda një mjedisi më të gjerë politikash europiane. Iniciativat evropiane, përfshirë Rekomandimin e BE-së 2021/1534[13] mbi mbrojtjen, sigurinë dhe fuqizimin e gazetarëve dhe profesionistëve të tjerë të medias dhe Direktivën (BE) 2024/1385[14], si dhe korniza e Aktit të Shërbimeve Digjitale dhe Kodi i Sjelljes kundër Dezinformimit, mbi luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, ofrojnë udhëzime shtesë për zhvillimin e përgjigjeve institucionale ndaj dhunës së mundësuar nga teknologjia dhe përmirësimin e mekanizmave mbrojtës për gratë.

Këto standarde evropiane në zhvillim[15] ofrojnë udhëzime të rëndësishme për forcimin e përgjigjeve institucionale ndaj dhunës ndaj grave të mundësuar nga teknologjia. Në kontekstin e përafrimit institucional të Kosovës me standardet përkatëse të Bashkimit Evropian dhe kornizat më të gjera të politikave evropiane, ato inkurajojnë përmirësime në mekanizmat e raportimit, koordinimin institucional, shërbimet e mbështetjes së viktimave dhe mjedise pune më të sigurta për gratë, përfshirë gratë që punojnë në sektorin e medias. Edhepse këto instrumente nuk janë drejtpërdrejt të detyrueshme në Kosovë, ato ofrojnë një referencë të rëndësishme për zhvillimin legjislativ dhe të politikave.

4.4 Zotimet e Kosovës në fushën e politikave

Korniza e politikave në Kosovë njeh gjithashtu rëndësinë e bashkëpunimit midis institucioneve publike, organizatave mediatike, shoqatave të gazetarëve dhe shoqërisë civile në adresimin e dhunës ndaj grave dhe promovimin e barazisë gjinore. Dokumentet përkatëse të politikave, përfshirë Strategjinë e Kosovës

[12] Për qëllimet e këtij raporti, dhuna me bazë gjinore (DHBGJ) i referohet dhunës, dëmit, abuzimit ose frikësimit të drejtuar kundër një personi për shkak të gjinisë, ose që prek në mënyrë disproporcionale personat e një gjinie të caktuar. Ajo përfshin format e abuzimit offline dhe të mundësuara nga teknologjia, duke përfshirë kërcënimet, ngacmimin seksual, ngacmimin online, doxxing-un, fushatat e shpifjes së seksualizuar dhe sulmet ndaj reputacionit që prekin gazetaret dhe gratë në media.

[13] Komisioni Evropian. (2021). Rekomandimi i Komisionit (BE) 2021/1534 i datës 16 shtator 2021 mbi Sigurimin e Mbrojtjes, Sigurisë dhe Fuqizimit të Gazetarëve dhe Profesionistëve të Tjerë të Medias në Bashkimin Evropian. Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian. Në dispozicion në: https://eur-lex.europa.eu/eli/reco/2021/1534/oj/eng (qasur në korrik 2026).

[14] Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Bashkimit Evropian. (2024). Direktiva (BE) 2024/1385 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 14 majit 2024 për Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje. Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian. Në dispozicion në: https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2024/1385/oj/eng (qasur në korrik 2026).

[40] Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK). (2025). Kërcënime të tjera ndaj gazetares Arbëreshë Uka. Në dispozicion në: https://ajk-ks.org/en/cases/kercenime-te-tjera-ndaj-gazetareve-arbereshe-uka-prishtine-06.08.2025/ (qasur në korrik 2026).

Megjithatë, dimensioni gjinor duhet të përcaktohet përmes përmbajtjes dhe kontekstit të secilit rast, në vend që të nxirret vetëm nga fakti që gazetarja e synuar është grua.

7.5 Pasiguria fizike dhe gjinia si faktor që rrit rrezikun

Gjatë protestave në Mitrovicë të Veriut në qershor 2023, Tatjana Lazarević, kryeredaktore e portalit në gjuhën serbe KoSSev, u sulmua fizikisht nga individë të maskuar teksa raportonte nga vendi i ngjarjes.[41] Sipas dokumentacionit të cituar, sulmuesit u përpoqën ta pengonin atë të filmonte, u përpoqën t'i merrnin telefonin celular dhe e tërhoqën për jelekun që ishte i shënuar qartë me simbole mediatike.

Provat në dispozicion nuk vërtetojnë se sulmi fizik në vetvete ishte në mënyrë të qartë i bazuar në gjini. Prandaj, ai duhet të kuptohet kryesisht si një sulm ndaj një gazetari që punon në një mjedis me rrezik të lartë dhe politikisht të ndjeshëm.

> Megjithatë, rasti është i rëndësishëm sepse ilustron ndërthurjen midis pasigurisë fizike, privatësisë, mbrojtjes së burimeve dhe cenueshmërisë që lidhet me gjininë. Gratë gazetare që punojnë në mjedise armiqësore mund të përballen me të njëjtat rreziqe fizike si kolegët e tyre meshkuj, ndërsa janë gjithashtu të ekspozuara ndaj kërcënimeve të seksualizuara, sulmeve ndaj reputacionit ose abuzimit të mëvonshëm në internet që synon gjininë ose jetën e tyre private.

7.6 Fushatat e personalizuara të denigrimit dhe narrativat më të gjera kundër barazisë gjinore

Duke u bazuar në angazhimin e QIKA-s me aktivistet dhe profesionistet e medias, Leonida Molliqaj vërejti se sulmet që synojnë gratë në jetën publike janë mbështetur gjithnjë e më shumë në narrativa shumë të personalizuara. Gratë që mbrojnë barazinë gjinore mund të etiketohen si "radikale", "anti-familjare" ose agjente të interesave të huaja, me sulme që shpesh përqendrohen në moralin, pamjen, jetën private ose legjitimitetin e tyre profesional.[42]

Sipas Molliqajt, përmbajtja mund të nxirret jashtë kontekstit ose të qarkullojë përmes faqeve anonime dhe llogarive të shumta në mediat sociale në mënyra që përforcojnë dëmtimin e reputacionit. Këto narrativa u drejtohen veçanërisht grave që flasin publikisht për dhunën me bazë gjinore, të drejtat riprodhuese, barazinë ose të drejtat e punës.

Një përmbajtje e tillë duhet të vlerësohet me kujdes. Jo çdo deklaratë fyese ose mizogjene përbën dezinformim. Koncepti zbatohet kur informacioni i rremë, mashtrues ose i manipuluar kombinohet me stereotipe gjinore ose narrativa seksiste për të diskreditуar gratë ose për të dekurajuar pjesëmarrjen e tyre publike.

Rëndësia më e gjerë e këtyre sulmeve qëndron në efektin e tyre të mundshëm dekurajues. Kur gratë e reja shohin gazetarë dhe aktivistë që i nënshtrohen vazhdimisht sulmeve personale, pretendimeve të rreme ose narrativave të seksualizuara, ato tregojnë më pak gatishmëri për t'u kyçur në gazetari, aktivizëm ose role të tjera publike.

[41] KoSSev. (2023). Lazarević: Godasin aty ku dhemb më shumë – Në mediat e shënjestruara nga autoritetet e kosovës dhe ato serbe si burimi i të gjitha të këqijave. Në dispozicion në: https://kossev.info/en/lazarevic-udaraju-tamo-gde-je-najslabije-u-medije-koje-i-kosovska-i-srpska-vlast-targetiraju-kao-vinovnike-zla/ (qasur në korrik 2026).

[42] Molliqaj, L. (2025). Intervistë e zhvilluar për raportin 'Gratë në media dhe dezinformimi me bazë gjinore në Kosovë'.

8.

Konkluzionet

Ky raport shqyrtoi se si dezinformimi me bazë gjinore ndikon te gratë gazetare dhe gratë që punojnë në sektorin e medias në Kosovë përmes një kombinimi të hulumtimit të dokumentacionit, një ankete sasiore, intervistave cilësore dhe një diskutimi në grup fokusi. Edhepse gjetjet duhet të interpretohen brenda fushëveprimit të studimit, ato vazhdimisht tregojnë se dezinformimi me bazë gjinore përfaqëson një sfidë të rëndësishme për pjesëmarrjen e grave në gazetari dhe jetën publike.

Hulumtimi sugjeron që gazetaret femra përballen me një kombinim të abuzimit në internet, dezinformimit me bazë gjinore, ngacmimit, sulmeve ndaj reputacionit dhe formave të tjera të abuzimit të mundësuar nga teknologjia që shpesh kanë në shënjestër gjininë, integritetin personal, besueshmërinë profesionale ose jetën e tyre private në vend të thelbit të punës së tyre gazetareske. Të anketuarat dhe pjesëmarrëset në intervista përshkruan pasoja që shtrihen përtej incidenteve individuale, duke përfshirë vetcensurën, ngurrimin për të marrë pjesë në debatin publik, besimin e reduktuar profesional dhe shqetësimet në lidhje me mbështetjen institucionale.

Diskutimet në takimin rajonal të Rrjetit SafeJournalists treguan më tej se shumë nga modelet e identifikuara në Kosovë - duke përfshirë sulmet mizogjene dhe të seksualizuara, ngacmimin kolektiv në internet, amplifikimin politik të narrativave armiqësore dhe përgjigjet e kufizuara institucionale - raportohen gjithashtu në tërë Ballkanin Perëndimor, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm rajonal dhe shkëmbimit të praktikave të mira.

Raporti ilustron më tej se dezinformimi me bazë gjinore rrallë ndodhë si dukuri e izoluar. Në praktikë, ai shpesh kryqëzohet me forma më të gjera të abuzimit online, duke përfshirë kërcënimet, doxxing-un, imazhet seksuale të manipuluara, ngacmimin dhe delegjitimizimin politik. Teksa këto forma sjelljeje duhet të mbeten të dallueshme ligjërisht dhe analitikisht, ato së bashku kontribuojnë në një mjedis në të cilin gratë gazetare mund të përballen me pengesa shtesë për të marrë pjesë në mënyrë të sigurt dhe të barabartë në jetën publike.

1Rishikimi i rasteve ilustruese tregon se përgjigjet institucionale mbeten të pabarabarta. Kornizat ekzistuese ligjore dhe të politikave ofrojnë një bazë të rëndësishme për mbrojtjen e grave nga dhuna, diskriminimi dhe sjellja e paligjshme në internet, e megjithatë sfidat e zbatimit ende ekzistojnë në fusha të tilla si mbledhja e provave, koordinimi institucional, procedurat e redaksisë, siguria digjitale dhe mekanizmat mbështetës për gazetarët që përjetojnë abuzim të mundësuar nga teknologjia.

Në të njëjtën kohë, raporti identifikon një numër zhvillimesh pozitive që ofrojnë një bazë për përparim të mëtejshëm. Këto përfshijnë punën e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës dhe Rrjetit të Grave Gazetare të Kosovës në dokumentimin e incidenteve dhe mbështetjen e gazetarëve, njohjen gjithnjë e më të madhe publike të dhunës ndaj grave të mundësuar nga teknologjia dhe harmonizimin e vazhdueshëm të kornizës ligjore dhe të politikave me standardet përkatëse ndërkombëtare dhe evropiane.

Një zhvillim veçanërisht i rëndësishëm i kohëve të fundit është miratimi i Strategjisë së re të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), e cila identifikon adresimin e rasteve të dhunës ndaj gazetarëve si një prioritet strategjik.[43] Kjo paraqet një mundësi të rëndësishme për të forcuar përgjigjet institucionale dhe për të përmirësuar koordinimin midis institucioneve të drejtësisë, agjencive të zbatimit të ligjit, shoqatave të gazetarëve dhe akterëve tjerë përkatës. Duke u bazuar në këtë angazhim, ndërkohë që integrohet një

[43] Betimi për Drejtësi. *Çka parasheh Plani Strategjik 2026–2028 për përmirësimin e qasjes në drejtësi*? Publikuar më 13 shkurt 2026. Në dispozicion në: https://betimiperdrejtesi.com/cka-parasheh-plani-strategjik-2026-2028-per-permiresimin-e-qasjes-ne-drejtesi/ (qasur në gusht 2026).

qasje gjinore ndaj dhunës që prek gratë gazetare, kjo mund të kontribuojë ndjeshëm në përmirësimin si të sigurisë së gazetarëve ashtu edhe të pjesëmarrjes së barabartë të grave në sektorin e medias.

Prandaj, adresimi i dezinformimit me bazë gjinore kërkon një përgjigje gjithëpërfshirëse që kombinon zbatimin efektiv të mbrojtjeve ekzistuese ligjore, bashkëpunimin më të fortë institucional, praktikat e përmirësuara të redaksisë, qëndrueshmëri më të madhe digjitale dhe mbështetjen e vazhdueshme për gratë gazetare. Rekomandimet e paraqitura më poshtë synojnë t'i mbështesin këto përpjekje duke identifikuar masa praktike që mund të ndërmerren nga institucione të ndryshme brenda mandateve të tyre përkatëse.

9.

Rekomandimet

Gjetjet e këtij raporti tregojnë se adresimi i dezinformimit me bazë gjinore që prek gratë gazetare kërkon veprime të koordinuara nga institucionet publike, organizatat mediatike, shoqatat e gazetarëve, organizatat e shoqërisë civile, platformat teknologjike dhe partnerët ndërkombëtarë. Gjersa shumë nga sfidat e identifikuara janë të ndërlidhura, akterë të ndryshëm kanë mandate dhe përgjegjësi të ndryshme. Prandaj, rekomandimet më poshtë u drejtohen grupeve specifike të akterëve dhe bëjnë dallimin midis prioriteteve afatshkurtra dhe afatmesme deri në ato afatgjata.

9.1 Institucionet publike, institucionet e zbatimit të ligjit dhe të drejtësisë

Prioritetet afatshkurtra

- Të mundësojnë përgjigje të shpejtë, të paanshme dhe me ndjeshmëri ndaj gjinisë ndaj rasteve të raportuara që përfshijnë kërcënime, ndjekje, ngacmim, doxxing, shpërndarjen pa pëlqim të imazheve intime, imazhe seksuale të manipuluara dhe sjellje të tjera që mund të përbëjnë një vepër penale ose shkelje ligjore kur drejtohen kundër grave gazetare.
- Të forcohet kapaciteti i zyrtarëve të policisë, prokurorëve dhe gjyqtarëve për të dalluar shprehjet e dëmshme, por të ligjshme, nga sjellja që mund të përbëjë vepër penale ose shkelje tjetër ligjore, duke respektuar plotësisht lirinë e shprehjes, privatësinë dhe procesin e rregullt ligjor.
- Të përmirësohet mbledhja e provave, ruajtja e provave digjitale dhe dokumentimi i abuzimit të mundësuar nga teknologjia që prek gratë gazetare.
- Të zbatohen zotimet e përfshira në Strategjinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës në lidhje me dhunën ndaj gazetarëve, duke siguruar që rastet që përfshijnë gratë gazetare të trajtohen përmes një qasjeje të ndjeshme ndaj gjinisë, aty ku është e përshtatshme.[44]

Prioritetet afatmesme dhe afatgjata

- Të zhvillohen udhëzime praktike ndërinstitucionale për identifikimin, dokumentimin, hetimin dhe reagimin ndaj dhunës së mundësuar nga teknologjia dhe sjelljeve që lidhen me dezinformimin me bazë gjinore, në përputhje me standardet përkatëse ndërkombëtare dhe që mund të bien brenda mandateve të institucioneve përkatëse.
- Të përmirësohet koordinimi institucional midis policisë, autoriteteve të prokurorisë, gjykatave, autoriteteve të mbrojtjes së të dhënave dhe institucioneve të tjera kompetente përgjegjëse për reagimin ndaj abuzimit në internet.
- Të forcohet mbledhja e të dhënave të ndara mbi sulmet kundër gazetarëve, duke përfshirë, aty ku është e mundur ligjërisht, të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe llojit të incidentit, me qëllim përmirësimin e zhvillimit të politikave dhe monitorimit institucional.

9.2 Institucionet e pavarura dhe rregullatorët e mediave

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM)

Prioritetet afatshkurtra

- Të forcohet bashkëpunimi me shoqatat e gazetarëve, organizatat mediatike dhe shoqërinë civile për të përmirësuar përgjigjet ndaj abuzimit online me bazë gjinore që prek gazetarët.

[44] Betimi për Drejtësi. *Çka parasheh Plani Strategjik 2026–2028 për përmirësimin e qasjes në drejtësi*? Publikuar më 13 shkurt 2026. Në dispozicion në: https://betimiperdrejtesi.com/cka-parasheh-plani-strategjik-2026-2028-per-permiresimin-e-qasjes-ne-drejtesi/ (qasur në gusht 2026)

- Të inkurajohen transmetuesit që të miratojnë ose forcojnë politikat e brendshme për parandalimin e ngacmimit dhe dhunës së mundësuar nga teknologjia kundër grave gazetare.

Prioritetet afatmesme dhe afatgjata

- Të promovohet udhëzimi rregullativ dhe ndërgjegjësimi mbi raportimin etik në lidhje me dhunën ndaj grave dhe përmbajtjen mediatike me ndjeshmëri gjinore.
- Të mbështeten nismat për edukim mediatik që adresojnë stereotipet gjinore, dëmet në internet dhe dhunën ndaj grave të mundësuar nga teknologjia.

Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP)

Prioritetet afatshkurtra

- Të përmirësohen udhëzimet publike mbi mekanizmat e ankesave që lidhen me zbulimin e paligjshëm të të dhënave personale, doxxing-un dhe shkelje të tjera të privatësisë që prekin gazetarët.
- Të forcohet bashkëpunimi me institucionet përkatëse dhe organizatat e shoqërisë civile për të përmirësuar ndërgjegjësimin për të drejtat e privatësisë digjitale.

Prioritetet afatmesme dhe afatgjata

- Të publikohen informata të përmbledhura mbi ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e privatësisë, duke respektuar kërkesat ligjore të konfidencialitetit.
- Të vazhdohen aktivitetet e ndërgjegjësimit mbi mbrojtjen e të dhënave personale në mjediset digjitale.

Institucioni i Avokatit të Popullit

Prioritetet afatshkurtra

- Të monitorohen ankesat që kanë të bëjnë me diskriminimin me bazë gjinore, abuzimin në internet dhe shkeljet e të drejtave të grave gazetare brenda mandatit të IAP-së.
- Të forcohet bashkëpunimi me shoqatat e gazetarëve dhe organizatat e shoqërisë civile për të lehtësuar referimet dhe për të përmirësuar qasjen në mjetet juridike në dispozicion.

Prioritetet afatmesme dhe afatgjata

- Të prodhohen analiza tematike dhe rekomandime mbi mbrojtjen e grave gazetare nga diskriminimi dhe dhuna e mundësuar nga teknologjia.
- Të promovohet bashkëpunimi institucional për të forcuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut në mjediset digjitale.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës

Prioritetet afatshkurtra

- Të promovohet zbatimi konsistent i standardeve etike në rastet që përfshijnë abuzimin në internet, ngacmimin me bazë gjinore dhe raportimin e dëmshëm.
- Të rritet ndërgjegjësimi midis gazetarëve dhe publikut rreth mekanizmave të ankesave vetërregulluese në dispozicion.

Prioritetet afatmesme dhe afatgjata

- Të vazhdohet me forcimin e udhëzimeve etike dhe standardeve profesionale mbi raportimin e dhunës ndaj grave dhe çështjeve të ndjeshme ndaj gjinisë.

- Të mbështeten nismat e trajnimit profesional dhe ndërgjegjësimit mbi raportimin etik dhe sigurinë në internet.

9.3 Pronarët e mediave, redaktorët dhe menaxherët e redaksive

Prioritetet afatshkurtra

- Të miratohen protokolle të qarta të brendshme për t'iu përgjigjur ngacmimeve online, dezinformimit me bazë gjinore dhe frikësimit offline që prekë gazetarët.
- Të krijohen mekanizma konfidencialë të raportimit të brendshëm, persona të caktuar kontakti dhe procedura për mbështetjen e gazetarëve që janë subjekt i abuzimit.
- Të sigurohet që gratë gazetare të marrin mbështetje të dukshme institucionale kur shënjestrohen për shkak të punës së tyre profesionale.

Prioritetet afatmesme dhe afatgjata

- Të institucionalizohen politikat e redaksisë që mbulojnë parandalimin, raportimin, dokumentimin, reagimin dhe mbështetjen pas incidentit për sulmet online dhe offline.
- Të promovohet një ekuilibër më i madh gjinorë në pozitat editoriale, menaxheriale dhe vendimmarrëse.
- Të integrohen qasje të ndjeshme ndaj gjinisë në politikat editoriale, procedurat e sigurisë në vendin e punës, menaxhimin e stafit dhe programet e zhvillimit profesional.
- Të ofrohen trajnime të rregullta mbi sigurinë digjitale, ngacmimin online dhe menaxhimin e redaksisë me qasje gjinore për redaktorët dhe menaxhmentin e lartë.

9.4 Asociacionet e Gazetarëve, Rrjetet e Grave Gazetareve dhe Organizatat e Shoqërisë Civile

Prioritetet afatshkurtra

- Të ruhen ose forcohen mekanizmat konfidencialë të raportimit dhe referimit për gratë gazetare që përjetojnë dezinformim me bazë gjinore ose forma të tjera të abuzimit të mundësuar nga teknologjia.
- Të përmirësohet qasja në ndihmë ligjore, mbështetje psikosociale, këshilla për sigurinë digjitale dhe mekanizma reagimi ndaj emergjencave për gazetarët e prekur.
- Të vazhdohet me dokumentimin e rasteve dhe avokimin publik për përgjigje efektive institucionale.

Prioritetet afatmesme dhe afatgjata

- Të monitorohen modelet e përsëritura të dezinformimit me bazë gjinore për të mbështetur avokimin e bazuar në prova, zhvillimin e politikave dhe procese strategjik gjyqësore kur është e përshtatshme.
- Të forcohen rrjetet e mbështetjes nga kolegët, veçanërisht për gazetarët e pavarur, gazetarët e rinj, gazetarët që punojnë jashtë qendrave të mëdha urbane dhe gratë nga komunitetet jo-shumicë.
- Të promovohet dialogu profesional mbi raportimin etik, qëndrueshmërinë digjitale dhe barazinë gjinore brenda sektorit të medias.

9.5 Partnerët dhe donatorët ndërkombëtarë

Prioritetet afatshkurtra

- Të mbështeten kërkimet dhe dokumentimi sistematik rreth dezinformimit me bazë gjinore dhe dhunës së mundësuar nga teknologjia që prek gratë gazetare.
- Të mbështeten programet që ofrojnë ndihmë ligjore, mbështetje psikosociale, siguri digjitale dhe ndërtim kapacitetesh për gratë gazetare.

Prioritetet afatmesme dhe afatgjata

- Të mbështetet zhvillimi i sistemeve të qëndrueshme për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave mbi sulmet ndaj grave gazetare, duke përfshirë informacionin e ndarë sipas gjinisë, aty ku është e përshtatshme.
- Të promovohet bashkëpunimi rajonal dhe shkëmbimi i praktikave të mira për mbrojtjen e grave gazetare nga dezinformimi me bazë gjinore dhe abuzimi në internet.
- Të mbështeten iniciativat që forcojnë njohuritë mediatike, barazinë gjinore dhe kapacitetin institucional për t'iu përgjigjur dhunës së mundësuar nga teknologjia.

Referencat

Agjencia e Kosovës për Barazi Gjinore. *Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020–2024*. Zyra e Kryeministrit. 2020. Në dispozicion në: https://www.prishtinaonline.com/uploads/programi_i_kosoves_per_barazi_gjinore_2020-2024_-_anglisht.pdf

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK). *AGK i bashkohet organizatave ndërkombëtare në dënimin e fushatës së vazhdueshme kundër Flutura Kusarit*. 2025. Në dispozicion në: https://agk-ks.org/en/news/agk-i-bashkohet-organizatave-nderkombetare-ne-denimin-e-fushates-se-vazhdueshme-te-mentor-llugaliut-ndaj-flutura-kusarit/

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK).*Sulm ndaj mediave*. 2024. Në dispozicion në: https://agk-ks.org/sq/cases/sulm-ndaj-mediave-prishtine-27.09.2024/

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK). *Kërcënime të tjera ndaj gazetares Albina Haliti*. 2025. Në dispozicion në: https://agk-ks.org/en/cases/kercenime-te-tjera-ndaj-gazetareve-albina-haliti-decan-28.09.2025/

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK). *Kërcënime të tjera ndaj gazetares Arbëreshë Uka*. 2025. Në dispozicion në: https://agk-ks.org/en/cases/kercenime-te-tjera-ndaj-gazetareve-arbereshe-uka-prishtine-06.08.2025/

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK). *Kërcënime ndaj gazetareve Ardiana Thaçi-Mehmeti dhe Erjona Gjikolli*. 2023. Në dispozicion në: https://www.agk-ks.org/en/cases/kercenim-ndaj-gazetareve-ardiana-thaci-mehmeti-dhe-erjona-gjikolli-prishtine-30.11.2023/

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK). *Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit: Gazetarët në Kosovë u ballafaquan me presion dhe sulme denigruese*. 2025. Në dispozicion në: https://agk-ks.org/en/news/raporti-i-dash-it-gazetaret-ne-kosove-u-ballafaquan-me-presion-dhe-sulme-denigruese/

Betimi për Drejtësi. *Çka parasheh Plani Strategjik 2026–2028 për përmirësimin e qasjes në drejtësi?* Publikuar më 13 shkurt 2026. Në dispozicion në: https://betimiperdrejtesi.com/cka-parasheh-plani-strategjik-2026-2028-per-permiresimin-e-qasjes-ne-drejtesi/

Këshilli i Evropës – GREVIO. *Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 1 mbi Dimensionin Digjital të Dhunës ndaj Grave.* 20 tetor 2021. Në dispozicion në: https://rm.coe.int/grevio-rec-no-on-digital-violence-against-women/1680a49147

Komisioni Evropian. *Rekomandimi i Komisionit (BE) 2021/1534 i datës 16 shtator 2021 mbi Sigurimin e Mbrojtjes, Sigurisë dhe Fuqizimit të Gazetarëve dhe Profesionistëve të Tjerë të Medias në Bashkimin Evropian*. 2021. Në dispozicion në: https://eur-lex.europa.eu/eli/reco/2021/1534/oj/eng

Federata Evropiane e Gazetarëve (FEG). *Kosovë: Mbështetje e palëkundur për Flutura Kusarin teksa ajo kërkon drejtësi kundër ngacmimit nga Mentor Llugaliu*. 2025. Në dispozicion në: https://europeanjournalists.org/blog/2025/06/20/kosovo-steadfast-support-for-flutura-kusari-as-she-seeks-justice-against-mentor-llugalius-harassment/

Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Bashkimit Evropian. *Direktiva (BE) 2024/1385 e 14 majit 2024 për Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje*. 2024. Në dispozicion në: https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2024/1385/oj/eng

Këshilli Gjyqësor i Kosovës. *Strategjia Gjyqësore 2025–2030*. Miratuar më 12 shkurt 2026. Në dispozicion në: https://www.gjyqesori-rks.org/2026/02/12/kgjk-miraton-planin-strategjik-2026-2028/

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD). Rezniqi, Arrita. *Konventa e Stambollit në Vendimet e Gjykatave në Kosovë*. 2022. Në dispozicion në: https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2023/03/The-Istanbul-Convention-in-the-verdicts-of-courts-in-Kosovo_ENG.pdf

KoSSev. *Lazareviç: Godasin aty ku dhemb më shumë – Në mediat e shënjestruara nga autoritetet e kosovës dhe ato serbe si burimi i të gjitha të këqijave*. 2023. Në dispozicion në: https://kossev.info/en/lazarevic-udaraju-tamo-gde-je-najslabije-u-medije-koje-i-kosovska-i-srpska-vlast-targetiraju-kao-vinovnike-zla/

Kusari, Flutura. Intervistë e zhvilluar për raportin *Gratë në media dhe dezinformimi me bazë gjinore në Kosovë*. 2025.

Koalicioni për Lirinë e Mediave. *Deklaratë për Ditën Ndërkombëtare për t'i dhënë fund mosndëshkimit për krimet kundër gazetarëve*. 2025. Në dispozicion në: https://mediafreedomcoalition.org/joint-statement/2025/mfc-statement-on-idei-2025/

Ministria e Drejtësisë. *Strategjia e Kosovës për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022–2026*. 2022. Në dispozicion në: https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/08/ENG-Strategjia-Kombetare-per-Mbrojtje-nga-Dhuna-ne-Familje-dhe-Dhuna-ndaj-Grave-2022-2026.pdf

Molliqaj, Leonida. Intervistë e zhvilluar për raportin *Gratë në media dhe dezinformimi me bazë gjinore në Kosovë*. 2025.

Posetti, Julie, & Shabbir, Nabeelah (Eds.). *The Chilling: A Global Study of Online Violence Against Women Journalists*. International Center for Journalists (ICFJ) and UNESCO. 2022. Në dispozicion në: https://www.icfj.org/sites/default/files/2022-11/ICFJ_UNESCO_The%20Chilling_2022_1.pdf

Rashiti, Valmira. *Hartëzimi i Dezinformimit Gjinor në Ballkanin Perëndimor: Kosova*. Rrjeti i Diversitetit të Raportimit. 2025. Në dispozicion në: https://www.reportingdiversity.org/wp-content/uploads/2025/07/Gendered_Disinformation_KS_fin.pdf

Sankar, Sonia.*"Mjedis armiqësor dhe i pasigurt": Gazetaret e Kosovës përballen me ngacmime online dhe offline*. *Perspektiva të Humbura*. 2025. Në dispozicion në: https://missingperspectives.com/posts/kosovo-women-journalists-face-harassment/

Telegrafi. *Si u publikuan numrat e telefonit të gazetarëve në grupin "AlbKings" në rrjetin social "Telegram"?*2024. Në dispozicion në: https://telegrafi.com/en/how-were-the-phone-numbers-of-the-journalists-published-in-the-albkings-group-on-the-Telegram-social-network/

Tuzi-Nushi, Vlorë. Intervistë me UN Women në Kosovë e zhvilluar për raportin *Gratë në media dhe dezinformimi me bazë gjinore në Kosovë*. 2025.

UNESCO.*CTRL + ALT + MUTE: CTRL + ALT + MUTE: Heshtja e një gazetareje grua është heshtja e një mijë zërave të grave*. 2025. Në dispozicion në: https://www.unesco.org/en/articles/ctrl-alt-mute-silencing-one-woman-journalist-silencing-thousand-womens-voices

Shtojcat

Shtojca 1. Instrumentet e mbledhjes së të dhënave

Kjo shtojcë ofron një përmbledhje të instrumenteve të hulumtimit të përdorura për mbledhjen e të dhënave. Instrumentet u hartuan për të siguruar konsistencë në të gjithë komponentët e ndryshëm të studimit, duke lejuar njëkohësisht fleksibilitet për të eksploruar temat e reja gjatë diskutimeve cilësore.

A. Anketa sasiore

Një pyetësor i strukturuar iu administrua gazetareve dhe grave që punojnë në sektorin e mediave në Kosovë. Pyetësori përbëhej nga pyetje demografike, pyetje me zgjedhje të shumëfishta dhe dy pyetje të hapura.

1. Si identifikoheni në aspektin e komunitetit ose etnisë?

- ☐ Shqiptar/e i/e Kosovës
- ☐ Serb/e i/e Kosovës
- ☐ Rom/e i/e Kosovës
- ☐ Turk/e i/e Kosovës
- ☐ Tjetër: _____
- ☐ Preferoj të mos përgjigjem

2. Cila është fusha juaj kryesore e punës në sektorin e mediave?

- ☐ Televizion
- ☐ Media online ose portal lajmesh
- ☐ Radio
- ☐ Media sociale
- ☐ Gazetari e pavarur
- ☐ Tjetër: _____

3. Cili opsion përshkruan më së miri pozitën tuaj aktuale profesionale?

- ☐ Pozitë e nivelit të ulët
- ☐ Raportim i nivelit të mesëm ose pozitë editoriale
- ☐ Pozitë e lartë editoriale, menaxheriale ose udhëheqëse
- ☐ Tjetër: _____

4. A keni përjetuar abuzim ose ngacmim në internet në lidhje me punën tuaj në gazetari ose media?

- ☐ Po
- ☐ Jo
- ☐ Preferoj të mos përgjigjem

5. Nëse iu përgjigjët me "Po" Pyetjes 4, a keni qenë në shënjestër të informacionit të rremë, mashtrues ose të manipuluar me bazë gjinore?

- ☐ Po
- ☐ Jo
- ☐ Nuk jam i/e sigurt
- ☐ Preferoj të mos përgjigjem
- ☐ Nuk aplikohet

6. Nëse keni përjetuar abuzim online ose dezinformim me bazë gjinore, a kishte komente ose pretendime të rreme në lidhje me pamjen, trupin, seksualitetin, moralin, jetën private, marrëdhëniet ose familjen tuaj?

- ☐ Po
- ☐ Jo
- ☐ Nuk jam i/e sigurt
- ☐ Preferoj të mos përgjigjem
- ☐ Nuk aplikohet

7. A ka ndodhur ndonjëherë që për shkak të shqetësimit për ngacmime ose sulme **online** të refuzoni ose shmangni një talk **show politik, panel, intervistë, debat publik ose paraqitje tjetër mediatike me dukshmëri të lartë?**

- ☐ Po
- ☐ Jo
- ☐ Nuk jam i/e sigurt
- ☐ Preferoj të mos përgjigjem

8. A ka redaksia ose organizata juaj mediatike mekanizëm të qartë të brendshëm, protokoll ose person të caktuar për raportimin e ngacmimeve, kërcënimeve ose sulmeve dezinformuese?

- ☐ Po
- ☐ Jo
- ☐ Nuk jam i/e sigurt
- ☐ Aktualisht nuk punoj për ndonjë redaksi lajmesh

9. A kanë pasur abuzimi, ngacmimi ose dezinformimi online efekte afatgjata në mirëqenien tuaj mendore, motivimin profesional, vetëbesimin, dukshmërinë publike ose gatishmërinë për të publikuar me emrin tuaj të vërtetë?

- ☐ Po
- ☐ Jo
- ☐ Nuk jam i/e sigurt
- ☐ Preferoj të mos përgjigjem
- ☐ Nuk aplikohet

10. Cilave institucione ose akterë do të kishit më shumë gjasa t'u drejtoheshit për mbështetje? Zgjedhni të gjitha **opsionet që mendoni se janë të përshtatshme.**

- ☐ Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës
- ☐ Policia e Kosovës
- ☐ Punëdhënësi ose redaksia ime
- ☐ Një organizatë e shoqërisë civile ose një organizatë për të drejtat e grave

- ☐ Prokuroria
- ☐ Gjykatat
- ☐ Një koleg, mik ose anëtar i familjes
- ☐ Nuk do të raportoja ose nuk do të kërkoja mbështetje
- ☐ Tjetër: _____

11. Në cilat platforma keni hasur më shpesh përmbajtje të rreme, abuzive ose me bazë gjinore që ka në shënjestër gratë gazetare ose gratë në jetën publike? Zgjedhni të gjitha **opsionet që mendoni se janë të përshtatshme.**

- ☐ Facebook
- ☐ Instagram
- ☐ TikTok
- ☐ X / Twitter
- ☐ YouTube
- ☐ Portale lajmesh online ose seksione komentesh
- ☐ Aplikacionet e mesazheve ose grupet private
- ☐ Tjetër: _____
- ☐ Nuk kam hasur përmbajtje të tillë

12. Ju lutemi përshkruani shkurtimisht çdo përvojë abuzimi, ngacmimi ose dezinformimi me bazë gjinore në internet që besoni se është e rëndësishme për këtë hulumtim.

13. Çfarë ndryshimesh do t'i bënin redaksitë, institucionet dhe platformat digjitale më të sigurta dhe më mbështetëse për **gratë gazetare?**

B. Udhëzues për intervistë gjysmë të strukturuar

Intervista gjysmë të strukturuara u zhvilluan me ekspertë dhe akterë që punojnë në fushat e gazetarisë, lirisë së mediave, barazisë gjinore, të drejtave digjitale dhe të drejtave të grave.

Ndërkohë që intervistat individuale ndryshonin sipas ekspertizës së të intervistuarit, ato trajtuan temat e mëposhtme:

- perceptimet e dezinformimit me bazë gjinore në Kosovë;
- trendet në zhvillim që ndikojnë te gratë gazetare;
- përgjigjet institucionale dhe sfidat ligjore;
- dhuna ndaj grave e mundësuar nga teknologjia;
- praktikat e redaksisë së lajmeve dhe mbështetja organizative;
- narrativat antigjinore dhe ndikimi i tyre në pjesëmarrjen publike;
- rekomandime për forcimin e parandalimit, mbrojtjes dhe përgjigjeve institucionale.

Pyetjet e intervistës u përshtatën aty ku ishte e nevojshme për të pasqyruar formimin profesional dhe përvojën e secilit pjesëmarrës në intervistë.

C. Udhëzues për diskutim në grupin e fokusit

Një diskutim në grup fokusi u organizua me anëtaret e Rrjetit të Grave Gazetare të Kosovës (RrGGK) për të validuar dhe kontekstualizuar më tej gjetjet e hulumtimit.

Diskutimi u përqendrua në:

- përvojat e pjesëmarrësve me ngacmimin online dhe dezinformimin me bazë gjinore;
- njohja e narrativave gjinore të përsëritura;
- efektet në besimin profesional dhe pjesëmarrjen e publikut;
- përgjigjet e redaksisë së lajmeve dhe mekanizmat e mbështetjes në dispozicion;
- përvojat e raportimit institucional;
- praktikat e sigurisë digjitale;
- rekomandime për përmirësimin e mbrojtjes dhe mbështetjes për gratë gazetare.

Grupi i fokusit u zhvillua duke përdorur një udhëzues diskutimi gjysmë të strukturuar, duke u lejuar pjesëmarrësve të jepnin hollësi mbi përvojat e tyre, duke siguruar njëkohësisht konsistencë në të gjitha temat kryesore të studimit.

Shtojca 2. Takimet dhe bashkëbiseduesit

Si pjesë e komponentit cilësor të këtij hulumtimi, ekipi i studimit kreu një seri intervistash gjysmë të strukturuara me ekspertë që punojnë në fushat e lirisë së medias, barazisë gjinore dhe të drejtave të grave. Përveç kësaj, u zhvilluan konsultime individuale me gazetarë, përvojat e të cilëve shërbyen si bazë për rastet studimore ilustrative të paraqitura në këtë raport. U organizua gjithashtu një diskutim në grup fokusi me anëtaret e Rrjetit të Grave Gazetare të Kosovës (RrGGK) për t'i validuar dhe kontekstualizuar gjetjet e hulumtimit.

A. Intervista me ekspertë

E intervistuara	Institucioni / Organizata	Ekspertiza
Vlora Tuzi-Nushi	UN Women Kosovo	Shefe e Zyrës
Flutura Kusari	Juriste e pavarur e medias	Liria e medias dhe liria e shprehjes
Leonida Molliqaj	QIKA – Qendra për Informim, Kritikë dhe Aksion	Barazia gjinore dhe të drejtat e grave

Këto intervista eksploruan trendet më të gjera që lidhen me dezinformimin me bazë gjinore, dhunën e mundësuar nga teknologjia, përgjigjet institucionale, sfidat ligjore, narrativat antigjinore dhe rekomandimet për forcimin e mbrojtjes së grave gazetare.

B. Konsultimet që shërbyen si bazë për rastet studimore ilustrative

Bashkëbiseduese	Organizata	Qëllimi
Ardiana Thaçi-Mehmeti	KIKS Kosova / TV Klan	Konsultim në lidhje me rastet e dokumentuara të ngacmimit online dhe rastin AlbKings.
Tatjana Lazareviç	KoSSev	Konsultim në lidhje me sulmin fizik të dokumentuar ndaj një gazetareje gjatë raportimit nga veriu i Kosovës.

C. Diskutim në grupin e fokusit

Aktiviteti	Pjesëmarrësit	Qëllimi
Diskutim në Grupin e Fokusit	Njëzet (20) anëtare të Rrjetit të Grave Gazetare të Kosovës (RrGGK)	Për të diskutuar përvojat e ngacmimit online, dezinformimit me bazë gjinore, praktikat e redaksisë, përgjigjet institucionale dhe për t'i validuar gjetjet e hulumtimeve të reja.

D. Temat e eksploruara gjatë hulumtimit cilësor

Intervistat dhe diskutimet në grupe të fokusit trajtuan fushat tematike të mëposhtme:

- përvojat e dezinformimit me bazë gjinore që prekin gratë gazetare;
- ngacmimi në internet dhe dhuna e mundësuar nga teknologjia;
- politikat e redaksisë së lajmeve dhe mekanizmat e mbështetjes organizative;
- përgjigjet institucionale nga institucionet e zbatimit të ligjit, institucionet e drejtësisë dhe organet rregullatore;
- narrativat antigjinore dhe ndikimi i tyre në pjesëmarrjen e grave në jetën publike;
- rekomandime për forcimin e parandalimit, mbrojtjes dhe llogaridhënies.

E. Prill 2026 – Takimi rajonal i Rrjetit SafeJournalists, Beograd, Serbi

Perspektivat rajonale të ndara gjatë takimit të Rrjetit SafeJournalists në prill 2026 treguan se përvojat e dokumentuara në Kosovë nuk janë të izoluara. Organizatat partnere raportuan modele të ngjashme në tërë Ballkanin Perëndimor, duke përfshirë sulme mizogjene dhe të seksualizuara kundër grave gazetare, njollosje të reputacionit, ngacmim të koordinuar në internet, amplifikim politik të narrativave armiqësore, përgjigje të dobëta institucionale dhe mekanizma të kufizuar brenda redaksive. Pjesëmarrësit theksuan gjithashtu se sulme të tilla kontribojnë gjithnjë e më shumë në vetëcensurë, dukshmëri të reduktuar publike dhe ngurrim midis grave gazetare për të mbuluar tema politikisht të ndjeshme ose të lidhura me gjininë. Në të njëjtën kohë, diskutimi vuri në dukje ndryshimet në kapacitetin institucional dhe përgjigjet ligjore në të gjitha vendet, duke përforcuar nevojën për një shkëmbim më të fortë të praktikave, standardeve të dokumentimit dhe bashkëpunimit rajonal.